

Kontroll mbi cilësinë e arsimit të lartë

Është mbajtur takimi i parë për të paraqitur projektin "Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë", program i cili ka të bëjë me kontrollimin e cilësisë në këtë nivel të arsimit



FOTO KUSHTRIM TERNAVA

MASH-t siguron cilësi në arsimin e lartë

Drita Vifia
Prishtinë, 26 mars

Ministria e Arsimit dhe "WUS Austria", në bashkëpunim me partnerët e tjerë vendorë dhe evropianë, kanë mbajtur një takim për projektin "Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë", i cili ka për qëllim të kontribuojë në themelimin, forcimin dhe sigurimin të cilësisë në dhjetë institucione private të arsimit të lartë të Kosovës (IPAL). Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, ka thënë se Republika e Kosovës gjatë vitit shkollor 2008-09 ka bërë përpjekje maksimale që ta definojë shtetin tonë si shtet në të cilin dija dhe kërkimi shkencor janë shtylla për zhvillim ekonomik, për modernizim social dhe për zhvillim kulturor. "Unë jam i nderuar që një prioritet të cilin e kemi filluar në vitin 2008-09 dhe i cili ka qenë i përmbledhur me tri fjalë, cilësi, cilësi, dhe vetëm cilësi, kemi bërë që në kuadër të procesit të akreditimit apo të vlerësimit të jashtëm ta rregullojmë tregun e dijes në fushën e arsimit të lartë dhe sot të dallojmë shumë prej vendeve tjera të rajonit sa

i takon asaj që universitetet tona publike dhe private, institucionet tona publike dhe private të mund të maten dhe mund të krahasohen me ato të cilat ekzistojnë në Bashkimin Evropian", ka thënë Hoxhaj. Sipas tij, kur përdoret nocioni kërkim shkencor, Kosova në fazën e saj të zhvillimit "është kjo që është dhe nuk mund të flasim për një kërkim shkencor i cili i kontribuon zhvillimit të cilësisë". "Nuk mund të ketë projekte shkencore të krijimit shkencor që zhvillohen dhe financohen nga industria, por institucionet tona të arsimit të lartë patjetër duhet të merren me kërkim, me shkencë e cila u mundëson që ato të ofrojnë standardin e fundit të dijes në mësimdhënie e cila u mundëson këtyre universiteteve që të lëvizin drejt ekselencës", ka thënë ministri.

Cilësi nga institucionet e arsimit të lartë

Ministri Hoxhaj, ka thënë se, nuk është qëllim i Ministrisë së Arsimit që vetëm ta promovojë akreditimin ose vlerësimin e jashtëm, por si mundësi që këto institucione të ofrojnë arsim cilësor. "Në asnjë formë, asnjë mënyrë në asnjë situatë ne nuk e kemi kuptuar këtë qasje si kontroll të ministrisë

mbi institucionet e arsimit të lartë, mirëpo si mundësi që këto institucione realisht të ofrojnë një arsimim më cilësor", ka theksuar ministri Hoxhaj. Ai ka shtuar se për MASH-tin, sektori publik dhe ai provat në Kosovë janë të barabartë për nga roli, për nga funksioni dhe për nga qëllimet. Por, sipas tij, përderisa sektori publik ekziston për shkak të domosdoshmërisë publike, sektori privat duhet të ekzistojë për shkak të cilësisë dhe për shkak të fleksibilitetit që ka ekonomia jonë e tregut. Ndërkohë, përfaqësuesja e Komisionit Evropian, Sophie Beamount, ka thënë se, projekti që është prezantuar, do t'i ndihmojë drejtpërdrejtë studentëve por edhe ekonomisë së Kosovës. "Komisioni Evropian e ka mbështetur projektin e TEMPUS-it, i cili është në koordinim me Sistemin e Bolonjës", ka thënë ajo.

Zhvillimi i cilësisë në vend

Ndërsa, përfaqësuesi i Universitetit të Salsburgut, Peter Eckl, është shprehur se Kosova tashmë e shpallur si Republikë në vetë i përmban edhe ngeçjet e saj sa u përket programeve të ndryshme hulumtuese shkencore. Ai ka shtuar se për këtë ar-

Kosova në mesin e vendeve evropiane

"Unë jam i nderuar kur Republika e Kosovës e ka mundësinë të bashkëpunojë me Austrinë, Rumaninë dhe Irlandën, me këto vende që kanë përvoja të ndryshme dhe zhvillim të ndryshëm, e ka mundësinë që në kuadër të arsimit të lartë të bashkëpunojnë në krijimin e mekanizmave dhe të strukturave për rritjen e cilësisë", ka thënë ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj.

sye duhet të sigurohet fillimisht kuadro me edukim të lartë institucional që do të mbështesin të rinjtë dhe t'u sigurojnë afirmimet me vendet tjera në zhvillim. Kurse, But Dedaj, përfaqësues nga WUS Austria, ka theksuar se, duke iu përgjigjur përkushtimit që ka pasur MASH-ti që është një nga proceset, shtyllat kryesore të procesit të Bolonjës, ai për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë si dhe deklarimi që viti 2009 ka qenë vit i sigurimit të cilësisë në këtë nivel të arsimit, ju kemi veshur punës që së bashku me Universitetin e Strasburgut ta zhvillojmë këtë projekt i cili do të kontribuojë zhvillimit të cilësisë në IPAL të Kosovës.